



Republika e Kosovës
Republika Kosova/ Republic of Kosova
Kuvendi /Sskupština / Assembly

Legjislatura III

Kryesia e Kuvendit

P-008

Prishtinë, më 10 mars 2008, në orën 12:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT ME KRYETARËT E GRUPEVE
PARLAMENTARE, TË MBAJTUR MË 10 MARS 2008**

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, Kryetar i Kuvendit dhe anëtarët e Kryesisë: Sabri Hamiti, Ibrahim Gashi, Nexhat Daci, Naim Maloku, Xhezair Murati dhe Eqrem Kryeziu, kurse munguan Xhavit Haliti dhe Sllobodan Petroviq.

Nga grupet parlamentare: Ramë Buja, Lulzim Zeneli, Zylfi Merxha dhe Ardian Gjini, kurse munguan Ibrahim Makolli dhe Bojan Stojanoviq .

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Rexhepi, Thëllënza Arifi dhe Sherif Konjufca;

Nga Kabineti i Kryetarit të Kuvendit: Eshref Vishi dhe Ismet Hajrullahu;

Nga NDI-ja: Rinor Beka dhe Ian Perkins, dhe

Nga OSBE-ja: Floriana Shala.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup Krasniqi**, Kryetar i Kuvendit të Kosovës.

Kryetari hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës, si dhe me materialet e shpërndara për këtë mbledhje.

Kryesia, me propozimin e Kryetarit, miratoi këtë

Rend dite:

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Kryesisë të mbajtur më 13, 17, 18 dhe 21 shkurt 2008,
2. Shqyrtimi i Vendimit për shpalljen e konkursit për Himnin e Republikës së Kosovës,
3. Shqyrtimi i Propozimit të Qeverisë për zgjedhjen e drejtorit të Autoritetit Qendror Bankar të Republikës së Kosovës,
4. Shqyrtimi i Propozimit të Qeverisë për zgjedhjen e anëtarëve të Komisionit Qendror për Regjistrimin e Popullsisë, të Ekonomive Familjare dhe të Banesave,
5. Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media për shqyrtimin e Rekomandimit për emërimin e dy anëtarëve të Këshillit në Komisionin e Pavarur të Mediave,
6. Caktimi i një deputeti të Kuvendit për vizitë në Irlandë,
7. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me ndarjen e mjeteve për financimin e partive politike të përfaqësuara në Kuvend dhe të grupeve parlamentare për vitin 2008,
8. Shqyrtimi i Projekt-Rregullores për organizimin dhe funksionimin e Kryesisë së Kuvendit,
9. Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit për Buxhet dhe Financa për lejimin e kompensimit të një eksperti,
10. Shqyrtimi i Raportit për shpenzimet e buxhetit të Kuvendit për vitin 2007,
11. Shqyrtimi i kërkesës së deputetit (ish-kryetarit të Kuvendit) Kolë Berisha për një zyrë pune.

II. Të ndryshme:

12. Njoftimi me raportin përfundimtar të Kuvendit të Kosovës gjatë legjislaturës së dytë,
13. Njoftimi i deputetit serb të Lidhjes së Socialdemokratëve të Pavarur të Kosovës për dalje nga Grupi Parlamentar i SLS-së, dhe
14. Njoftimi i Shoqatës së Pensionistëve të Kosovës lidhur me çështjen e pensionistëve.

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Kryesisë të mbajtur me 13, 17, 18 dhe 21 shkurt 2008

Procesverbalet e mbledhjeve të Kryesisë së Kuvendit të mbajtura me 13,17,18 dhe 21 shkurtit 2008 u miratuan pa vërejtje.

Sabri Hamiti propozoi që Kryesia të marrë qëndrim lidhur me diskutimet, që nuk regjistrohen, të zbardhen apo të mos zbardhen në transkript. Ai këtë e arsyetoi se shpesh po ndodhë kur diskutohet pa incizim, kurse ato zbardhen në transkript. Në këtë mënyrë rrjedha e diskutimeve nuk lidhet.

2. Shqyrtimi i vendimit për shpalljen e konkursit për Himnin e Republikës së Kosovës

Kryetari i njoftoi të pranishmit se Qeveria dhe Presidenca i kanë propozuar Kuvendit, që të iniciojë procedurën për përcaktimin e kriterëve për Himnin e Republikës së Kosovës dhe në bazë të tyre të shpall konkurs.

Kryesia pas diskutimeve të të gjithë anëtarëve, vendosi që shqyrtimin e kësaj çështje ta shtyjë për mbledhjen e ardhshme dhe pas sqarimit të dilemave me Qeverinë që dolën në këtë mbledhje.

3. Shqyrtimi i Propozimit të Qeverisë për zgjedhjen e drejtorit të Autoritetit Qendror Bankar të Republikës së Kosovës

Kryetari i informoi të pranishmit se kjo kërkesë e Qeverisë është në pajtim me Nenin 18 (2) (a) të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2006/47, për Autoritetin Qendror Bankar të Kosovës, që përcakton se Drejtori menaxhues do të caktohet me propozim të IPVQ-ve dhe pas miratimit nga Kuvendi dërgohet për emërim nga PSSP-ja.

Kryesia vendosi që propozimin e Qeverisë ta radhisë si pikë të rendi të ditës për seancën plenare të radhës.

4. Shqyrtimi i Propozimit të Qeverisë për zgjedhjen e anëtarëve të Komisionit Qendror për Regjistrimin e Popullsisë, të Ekonomive Familjare dhe të Banesave

Kryetari i informoi të pranishmit se kjo kërkesë e Qeverisë është në pajtim me Nenin 12 (1) dhe (2) të Ligjit për regjistrimin e popullsisë, të ekonomive familjare dhe të banesave në Kosovë.

Sabri Hamiti propozoi që në kuadër të listës për anëtarët e Komisionit Qendror për Regjistrimin e Popullsisë të jetë edhe akademik Hivzi Islami, si njohësi më i mirë i demografisë.

Nexhat Daci e përkrahu këtë propozimin dhe shtoi se Hivzi Islamit mund të përfshihet si anëtarë i Akademisë së Shkenca dhe të Arteve të Kosovës.

Ibrahim Gashi përkrahu propozimet e mësipërme dhe shtoi se kësaj liste duhet t'i shtohet edhe një përfaqësues nga Arkivi i Kosovës.

Kryesia, pas diskutimeve, vendosi që propozimin e Qeverisë ta radhisë si pikë të rendi të ditës për seancën plenare të radhës.

5. Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media për shqyrtimin e Rekomandimit për emërimin e dy anëtarëve të Këshillit në Komisionin e Pavarur të Mediave

Kryesia, pasi shqyrtoi propozimin e Komisionit për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media për emërimin e dy anëtarëve të Këshillit në Komisionin e Pavarur të Mediave, vendosi që ta radhisë si pikë të rendit të ditës për seancën plenare të radhës.

6. Caktimi i një deputeti të Kuvendit për vizitë në Irlandë

Kryetari i informoi të pranishmit lidhur me ftesën që e ka bërë Komisioni për Çështje Evropiane i Parlamentit të Irlandës që një deputet nga Komisioni për Integritet Evropiane të Kuvendit të Republikës së Kosovës ta vizitojë Irlandën.

Kryesia, pasi shqyrtoi ftesën, mori këtë :

V E N D I M

1. Deputetja Edita Tahiri, anëtare e Komisionit për Integritet Evropiane, të shkojë në takim e ftuar në Irlandë, prej datës 14 deri më 18 prill 2008,
2. Shpenzimet e udhëtimit dhe të qëndrimit të deputetes, sipas paragrafit një (1) të këtij vendimi, i përballon Buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

7. Shqyrtimi i Rekomandimi të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me ndarjen e mjeteve për financimin e partive politike të përfaqësuara në Kuvend dhe të grupeve parlamentare, për vitin 2008

Kryetari i informoi të pranishmit se Komisioni për Buxhet dhe Financa, në pajtim me rregullën 6.7 dhe 51.2 të Rregullores së Punës së Kuvendit ka shqyrtuar mënyrën e ndarjes së mjeteve për financimin e partive politike të përfaqësuara në Kuvend si dhe të grupeve parlamentare dhe ka propozuar që këto mjete të ndahen sipas kriterëve të vendeve të fituara nga partitë politike në zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës .

Kryesia, pasi shqyrtoi rekomandimin, mori këtë

V E N D I M

për ndarjen e mjeteve për financimin e partive politike të përfaqësuara në kuvendin e kosovës dhe të grupeve parlamentare për vitin 2008

I. Në kuadër të buxhetit të miratuar për Kuvendin e Kosovës për vitin 2008, mjetet financiare nga kategoria e Subvencioneve dhe transferove paraqesin mjetet e ndara për financimin e partive politike, të përfaqësuara në Kuvendin e Kosovës, në shumën prej 1.901.783€. Këto mjete u ndahen partive politike sipas kriterit të vendeve të fituara në zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës, në shumën prej 1.812.240,72€, sipas Shtojcës nr.1.

II. Për financimin e grupeve parlamentare ndahen mjete prej 5% nga mjetet e ndara sipas pikës I. Këto mjete (5%) ti ndahen vetëm grupeve parlamentare që përbëhen nga partitë politike nga buxheti i paraparë për partinë e përfaqësuar në grupin parlamentar. Në rast të përbërjes së një grupi parlamentar nga dy ose më shumë parti, mjetet ndahen në proporcion sipas përfaqësimit të tyre në grupin parlamentar. Mjetet u alokohen grupeve parlamentare të Kuvendit të Kosovës, dhe për këtë arsye grupet parlamentare duhet të kenë xhiro kontot e tyre, në shumën prej 89.542,28€, sipas Shtojcës nr.2.

8. Shqyrtimi i Projekt-rregullores për organizimin dhe funksionimin e Kryesisë së Kuvendit

Kryesia vendosi që Projekt-Rregulloren për organizimin dhe funksionimin e Kryesisë së Kuvendit ta shtyjë për mbledhjen tjetër të radhës.

9. Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit për Buxhet dhe Financa për lejimin mjeteve për kompensimin e një eksperti

Kryetari i njoftoi të pranishmit se Komisioni për Buxhet dhe Financa, në pajtim me Rregullën 44.3 të Rregullores së Punës së Kuvendit, ka bërë kërkesë për lejimin e mjeteve për kompensimin e një eksperti.

Kryesia, pasi shqyrtoi këtë kërkesë, nxori këtë

P e r f u n d i m

Kërkohet nga Komisioni për Buxhet dhe Financa që ta përcaktojë shumën e mjeteve që nevojitet për kompensimin e ekspertit, për të cilin ky komision ka nevojë.

10. Shqyrtimi i Raportit për shpenzimet e buxhetit të Kuvendit për vitin 2007

Kryetari kërkoi nga sekretari i Kuvendit të jep sqarime lidhur me shpenzimet buxhetore të Kuvendit për vitin 2007.

Sekretari i Kuvendit, **Ismet Krasniqi**, bëri një përmbledhje të shkurtër të raportit për secilin pozicion, veç e veç, duke i krahasuar ato me shpenzimet e vitit 2006. Ai, gjithashtu, kërkoi nga Kryesia që në ndonjërin nga mbledhjet e ardhshme të shqyrtohet çështja e shpenzimeve kapitale lidhur me Qendrën Protokollare “Vila Gërmia”, e cila është pronë e Kuvendit.

Kryesia, pasi e shqyrtoi këtë raport, mori këtë

V E N D I M

Miratohen Raporti i shpenzimeve të buxhetit të Kuvendit për vitin 2007, sipas pasqyrave të prezantuara.

11. Shqyrtimi kërkesës së deputetit (ish-kryetarit të Kuvendit) Kolë Berisha për një zyre

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e deputetit Kolë Berisha për ndarjen e një zyre të punës mori këtë

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa e ish-kryetarit të Kuvendit, Kolë Berisha për t’ia ndarë një zyre të punës.
2. Ngarkohet Administrata e Kuvendit që ta caktojë dhe ta pajisë me inventar të nevojshëm një zyrë pune për ish-kryetarin e Kuvendit, Kolë Berisha.

II. Të ndryshme:

12. Njoftimi me raportin përfundimtar të Kuvendit të Kosovës gjatë Legjislaturës së dytë

Kryesia u njoftua lidhur me raportin e Kuvendit të Kosovës gjatë Legjislaturës së dytë, të cilin, Administrata duhet ta publikohet në faqen e internetit të Kuvendit.

13. Njoftimi i deputetit serb të Lidhjes së Socialdemokratëve të Pavarur të Kosovës për dalje nga Grupi Parlamentar i SLS-së

Kryesia shtyu shqyrtimin e kësaj pike deri sa të zgjidhet çështja mes deputetëve Dimiq dhe Zhiviq nga autoritet kompetente.

14. Njoftimi i Shoqatës së Pensionistëve të Kosovës lidhur me çështjen e pensionistëve

Kryesia u njoftua me shkresën e pensionistëve, e cila u ishte drejtuar institucioneve të Republikës së Kosovës lidhur me zgjidhjen e çështjes së pensioneve për pensionistët kontribut-pagues, me qëllim të gjetjes së një zgjidhjeje adekuate.

Kryetari e deklaroi mbledhjen të mbyllur në orën 13 : 35.

Jakup KRASNIQI

E hartoi:

Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale